



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK

Nr. 2985/5 Prot.

Vlorë më, 20.11.2025

VENDIM

Nr. 105 datë 20.11 2025

**PËR
MIRATIMIN E KOMISIONIT AD-HOC PËR VLERËSIMIN E
DOKUMENTACIONIT TË DORËZUAR NGA KANDIDATËT PËR ANËTARË TË
KOMITETIT TË ETIKËS NË KËRKIM NË UNIVERSITETIN "ISMAIL QEMALI",
VLORE**

Në mbështetje të nenit 38 të Ligjit nr. 80/ 2015 "*Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë*", nenit 19 të Statutit të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë; nenit 13 dhe 127 të Rregullores së Brendshme të UV-së; ligjit nr. 8480, datë 27.05.1999 "*Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike*"; Senati Akademik në mbledhjen e datës 20.11.2025:

VENDOSI:

1. Të miratojë ngritjen e Komisioni *ad-hoc* për vlerësimin e dokumentacionit të dorëzuar nga kandidatët për anëtarë të Komitetit të Etikës në Kërkim, në Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë si më poshtë vijon:

- Prof. Asoc. Denada Sota (kryetar)
- Prof. Dr. Elenica Pjero (anëtar)
- Kristi Metushi (anëtar)

2. Komisioni *ad-hoc* të hartojë një relacion për Senatin Akademik, në të cilin pasqyrohet plotësimi ose jo i kriterëve për secilin kandidatë.
3. Relacioni i komisionit *ad-hoc* t'i përcillet Senatit Akademik, në mbledhjen më të afërt të tij.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK

Prof. Dr. Aurela Saliaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK**

Nr. 2530/10 Prot.

Vlorë më, 16 . 10 .2025

VENDIM

Nr. 99, datë 16/10.2025

**PËR
HAPJEN E THIRRJES PËR VETKANDIDIM PËR ANËTARË TË
KOMITETIT TË ETIKËS NË KËRKIM
NË UNIVERSITETIN "ISMAIL QEMALI" VLORE**

Në mbështetje të nenit 38 të Ligjit nr. 80/ 2015 "*Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë*", nenit 19, të Statutit të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë, nenit 13 dhe 127 të Rregullores së Brendshme të UV-së, ligjit Nr. 8480, datë 27/05/1999 "*Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike*", Kodi i Cilësisë së Arsimit të Lartë miratuar me VKM Nr. 824, datë 24/12./2021, Senati Akademik në mbledhjen e tij të datës 16.10.2025,

VENDOSI:

1. Të miratojë hapjen e thirrjes për vetkandidim, për 5 nga 7 anëtarët e Komitetit të Etikës në Kërkim në Universitetin "Ismail Qemali" Vlorë, në periudhën 20-31 Tetor 2025.
2. Anëtarët e përzgjedhur nga Senati Akademik për Komitetin e Etikës në Kërkim, sipas nenin 127 të Rregullores së UV-së, janë:
 - a) katër anëtarë – personel akademik me kohë të plotë, një nga çdo njësi kryesore,
 - b) një anëtarë – student, nga të gjitha njësitë kryesore.
3. Kriteret e kandidimit të personelit akademik:
 - niveli akademik: kategoria Profesor ose PhD
 - eksperiencia në kërkim shkencor: drejtues projekti kërkim-zhvillimi në minimumi 2 (dy) projekte UV ose 1 (një) projekt kombëtar.
4. Kriteret e kandidimit për anëtarin student:
 - cikli i studimeve: i dytë ose i tretë
 - nota mesatare e ciklit paraardhës të studimeve: minimalisht 8
 - eksperiencia në kërkim shkencor: pjesëmarrës në një grup pune në projekt kërkim-zhvillimi ose autor i një teme diplome.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK**

5. Pjesëmarrja në organe të tjera kolegjiale / detyra administrative nuk përbën pengesë për pjesëmarrje në Komitetin e Etikës në Kërkim.
6. Personeli akademik dhe studentët që duan të vetkandidojnë për anëtarë të Komitetit të Etikës në Kërkim dorëzojnë Formularin e Vetkandidimit në Zyrën e Protokollit në Rektorat. Në fund të periudhës së vet-kandidimit formularët dorëzohen në Senatin Akademik (sekretarja teknike) për ndjekjen e procedurave të mëtejshme.
7. Dy anëtarët e tjerë, Kryetari i Komitetit dhe Përgjegjësi i sektorit të Kërkimit shkencor dhe Projekteve, bëhen pjesë e Komitetit të Etikës në Kërkim si pasojë e detyrave funksionale që ushtrojnë në pozicionet administrative përkatëse.
8. Ngarkohet për zbatimin e këtij Vendimi Drejtoria e Shërbimeve Ndihmës Akademike (Sektori i Burimeve Njerëzore) dhe Drejtoria e Kërkim-Zhvillimit dhe Marrdhënieve me të tretët.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK

Prof. Dr. Aurela Saliaj

